

Shqipëri Java e Shoqërisë Civile 2023

#AFTËSIPËRTËGJITHË
PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR





Ky projekt financohet nga
Bashkimi European

Java e
Shoqërisë
Civile
Shqipëri
2023

 **PARTNERËT SHQIPËRI**
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

 **QENDRA KOMBËTARE BURIMORE**
PËR **SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI**

**© Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri; Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.
Tiranë, Shqipëri 2023**

Ky publikim u përgatit me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Europian

shqipëri
**Java e
Shoqërisë
Civile**
2023

 **PARTNERËT SHQIPËRI**
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

 **QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI**

Për të dytin vit radhazi, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri në partneritet me aktorë të shoqërisë civile në mbarë vendin, organizuan Javën e Shoqërisë Civile 2023, një seri eventesh dhe hapësirë promovimi tematike, dedikuar punës dhe veprimtarisë së organizatave dhe aktivistëve të shoqërisë civile në vend.

Java krijon mundësi për të gjithë aktorët e shoqërisë civile, për t'u bërë bashkë, si katalizatorë të ndryshimeve pozitive në shoqëri, për të diskutuar dhe krijuar zgjidhje dhe veprime të përbashkëta në të ardhmen.

Në linjë me Javën e Evropës dhe shpalljen nga Komisioni Evropian të vitit 2023 si "Viti Evropian i Aftësive", Java e Shoqërisë Civile këtë vit iu dedikua veprimtarisë dhe kontributit të organizatave të shoqërisë civile për edukimin dhe aftësimin e grupeve të ndryshme në shoqëri, kryesisht të rinjve dhe grupeve më në nevojë nën moton **"Aftësi për të gjithë: Për të mësuar, punuar, angazhuar"**.

Në kuadër të Javës u organizuan mbi 120 aktivitete në mbarë vendin, me pjesëmarrjen e organizatave dhe aktivistëve të shoqërisë civile si dhe përfaqësuesve të institucioneve qeverisëse në nivel qendror e vendor, shkollave profesionale, universiteteve, biznesit, medias, etj.

JAVA E SHOQËRISË CIVILE 2023

Ky dokument është një përmbledhje e aktiviteteve të organizuara në kuadër të JSHC 2023, aktorëve të përfshirë si dhe diskutimeve dhe rekomandimeve të gjeneruara përgjatë workshopeve tematike të eventit kombëtar.



PËRMBLEDHJE

Java e Shoqërisë Civile 2023



Pjesëmarrës në
aktivitete
2500



Aktivitete Lokale
120



Event Kombëtar
1




OSHC
të angazhuara
75



Shkolla dhe
Universitete
50



Institucione
publike
25



Organizata të reja
të angazhuara



Organizata ekzistuese



70

Postime



150

Ndjekës të rinj




17K

Arritje në
Facebook



5430

Angazhuar në
Instagram




120 AKTIVITETE LOKALE

Evente të organizuara dhe promovuara


Aftësim për jetën




Aftësim për median dhe informacioni



Aftësim digjital dhe mjedisor




Aftësim për punësim dhe vetëpunësim



Aftësim për angazhim në politikbërje



Aftësim për transferimin e njohurive



75 OJF të angazhuara

1. Act for Society
2. Agjencia Rajonale e Zhvillimit
3. Akropoli i Ri
4. Albanian Skills
5. AlbContact
6. Antigonea
7. AOS-Albanian Ornithological Society
8. Artizanët Vau Dejës
9. Celim Shqipëri
10. Change and Development Center
11. Conservation Youth Club (CYC)
12. Diakonia Agapes
13. Durrësi Aktiv
14. Eco Albania
15. Engim
16. Fondacioni "Joscelyn"
17. Fondacioni "Misioni Emanuel"
18. Fondacioni "Oda"
19. Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar
20. Forumi Civil Selenicë
21. Forumi Gruas Elbasan
22. Fshati SOS
23. Go2
24. Gruaja tek Gruaja
25. IMPACT Club
26. Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA)
27. Instituti Liberal Pashko
28. Instituti për Zhvillim dhe Inisiativa Qytetare (IZHIQ)
29. Junior Achievement Albania (JAA)
30. Kongresi Rinor Kombëtar
31. Kryqi i Kuq Shqiptar
32. KS Factor
33. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
34. MEDPAK - Mbrojtja e Personave me Aftësi të Kufizuara
35. MuZEH Lab
36. New Vision
37. Nisma për Ndryshim Shoqëror (ARSI)
38. Open Window
39. Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

40. Përtej Barrierave
41. Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCIDEV)
42. Qendra "Trokitje"
43. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
44. Qendra Aulona
45. Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"
46. Qendra Inovative Kualifikuese Edu Act Albania
47. Qendra për Advokim Social
48. Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri
49. Qendra Psiko Sociale "Vatra"
50. Qendra Rinore Atelie
51. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD)
52. Qendra Shqiptare YMCA
53. Qendra Strehë
54. Rrjeti "Zëri i të Rinjve"
55. Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
56. Shoqata "Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Qytetare e Fshatare"
57. Shoqata "The Roots"
58. Shoqata "Qendra Sociale në Ndhim të Njerëzve në Nevojë"
59. Shoqata e Natyrës dhe Turizmit Bulqizë
60. Shoqata Italiane e Veriut
61. Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ)
62. Shoqata Multifunkionale për Kulturë, Zhvillim dhe Edukim
63. Shoqata për Gratë Femere Tregan
64. Social Inclusion for Development (SID)
65. Të Ndryshëm të Barabartë
66. Terre des Hommes
67. TID Gjirokastra
68. TVO NGO
69. Unioni i Gazetarëve
70. Ura të Reja
71. Voice of Roma in Albania
72. Wikipedianët e Gjuhës Shqipe
73. World Vision Albania
74. Young Professionals for Agricultural Development Albania
75. Youth Rights and Citizenship Initiative (YRCI)

50 Shkolla & Universitete të angazhuara

1. Kolegji Profesional i Tiranës
2. Shkolla "1 Maji"
3. Shkolla "14 Engjëjt"
4. Shkolla "28 Nëntori"
5. Shkolla "Arben Broci"
6. Shkolla "Dertliu"
7. Shkolla "Epoka e Re"
8. Shkolla "Fiqiri Dine"
9. Shkolla "Gjergj Pekmezi"
10. Shkolla "Gjergj Vatë Martini"
11. Shkolla "Gjok Shqiptari"
12. Shkolla "Hamdi Bushati"
13. Shkolla "Isuf Gjata"
14. Shkolla "Jordan Misja"
15. Shkolla "Koli Gusho"
16. Shkolla "Kolin Gjoka"
17. Shkolla "Kristaq Capo"
18. Shkolla "Kushtrimi i Lirisë"
19. Shkolla "Liri Gero"
20. Shkolla "Maria Ndhimtare"
21. Shkolla "Marie Kaçulini"
22. Shkolla "Muharrem Collaku"
23. Shkolla "Nënë Tereza"
24. Shkolla "Oso Kuka"
25. Shkolla "Partizani"
26. Shkolla "Pjetër Meshkalla"



27. Shkolla "Planetary"
28. Shkolla "Rilindja"
29. Shkolla "Sali Gjuka"
30. Shkolla "Sevasti Qiriazhi"
31. Shkolla "Sheme Mahmutllari"
32. Shkolla "Skënderbej"
33. Shkolla "Besnik Sykja"
34. Shkolla "Ferem Clirim"
35. Shkolla "Gjergj Kastriot Skënderbeu"
36. Shkolla "Rakip Kryeziu"
38. Shkolla "Shejnaze Juka"
39. Shkolla e Mesme "Ptoleme Xhuvani"
40. Shkolla e mesme profesionale "Petro Sota"
41. Shkolla Shupenzë
42. SHMB Roshnik
43. Universiteti "Aleksandër Moisiu"
44. Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
45. Universiteti "Fan Noli"
46. Universiteti "Ismail Qemali"
47. Universiteti "Luigj Gurakuqi"
48. Universiteti Europian i Tiranës
49. Universiteti i Tiranës
50. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

25 Institucione

1. Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
3. Bashkia Belsh
4. Bashkia Berat
5. Bashkia Elbasan
6. Bashkia Gjirokastër
7. Bashkia Kamëz
8. Bashkia Korçë
9. Bashkia Kurbin
10. Bashkia Lezhë
11. Bashkia Maliq
12. Bashkia Mirditë

13. Bashkia Përrenjas
4. Bashkia Pogradec
15. Bashkia Tiranë
16. Bashkia Vlorë
17. Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan
18. Drejtoria Rajonale e Punësimit Korçë
19. Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional
20. Ministria e Arsimit dhe Sportit
21. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
22. Zyra e Punësimit Librazhd
23. Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë
24. Zyra Vendore Arsimore Lezhë
25. Zyra Vendore Arsimore Shkodër

PROMOVIMI DHE MBULIMI MEDIATIK



▶ [Spot promovues i Javës së Shoqërisë Civile 2023](#)

EVENT KOMBËTAR PUBLIK



EVENT KOMBËTAR PUBLIK

#Aftësipërtëgjithë



Konceptuar si një pikë takimi e të gjithë aktorëve të përfshirë eventit solli bashkë

120

pjesëmarrës nga OSHC-të, aktivistë, të rinj, institucione qeverisëse në nivel vendor dhe qendror, institucione akademike dhe media

4

panelistë përfaqësues të OSHC-ve, institucioneve publike dhe arsimore


5

Workshope tematike

1. Aftësitë për jetën
2. Demokracia pjesëmarrëse: Fuqizimi i aftësisetë qytetarëve dhe grupeve të interesit për më shumë angazhim në politikëbërje
3. Aftësimi dhe integrimi në punë dhe shoqëri i personave me nevoja dhe aftësi të veçanta
4. Punësimi dhe vet-punësimi; Zhvillimi i aftësive për ekonomi më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse
5. Aftësimi dhe integrimi i personave nga grupe të disavantazhuara

50

kontribues me prezantime në diskutimet tematike



Panel Diskutimi

"AFTËSI PËR TË GJITHË" PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR

Shqipëri
2023

Java e Shoqërisë Civile

Në fjalën e saj përshëndetëse, Znj. Ariola theksoi rolin e rëndësishëm që sektori i shoqërisë civile ka luajtur dhe vazhdon të luajë në edukimin dhe promovimin e aftësive për jetën si dhe në zbatimin e programeve të zhvillimit të këtyre aftësive kryesisht me grupet në nevojë, duke sjellë dhe zbatuar modele të reja dhe praktika të mira në këtë kuadër. Ajo u ndal dhe në rëndësinë e bashkëpunimit OSHC-institucione shtetërore-donatorë-akademi për ndërhyrje sa më të koordinuara dhe bazuar në nevoja.

Ariola Agolli

Manaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Partnerët Shqipëri



"AFTËSI PËR TË GJITHË" PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR

Shqipëri
2023

Java e Shoqërisë Civile

Znj. Joniada Hito ndau modelin e suksesshëm të pilotuar prej vitesh dhe tashmë të konsoliduar, të Zyrës së Këshillimit të Karrierës si një ofrues informacioni dhe këshillimi mbi tregun e punës dhe mundësitë për punësim, si dhe programe të tjera të Bashkisë Tiranë me fokus aftësimin e grupeve në nevojë dhe integrimin social të tyre."

Joniada Hato

Përgjegjëse e Sektorit të Këshillimit të Karrierës, Bashkia Tiranë



"AFTËSI PËR TË GJITHË" PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR

Shqipëri
2023

Java e Shoqërisë Civile

Znj. Marsida Hyseni prezantoi disa nga programet e AKPA si një ndër institucionet kryesore përgjegjëse për punësimin dhe zhvillimin e aftësive të qytetarëve, përmes zbatimit të politikave aktive të tregut të punës, programeve të formimit profesional dhe integritimit social, në bashkëpunim me partnerë strategjikë ndërsektoriale.

Marsida Hyseni

Drejtoresha Rajonale, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim



"AFTËSI PËR TË GJITHË" PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR

Shqipëri
2023

Java e Shoqërisë Civile

Znj. Adela Danaj ndau përvojën e Universitetit European të Tiranës në programet e këshillimit të karrierës, dhe në ndërthurjen e ofertës akademike me atë praktike, duke u ndalur në rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe sektorë të tjerë në këtë kuadër.

Adela Danaj

Drejtoresha e Programesh, Zyra e Marrëdhënieve Ndërinstitucionale në Universitetin European të Tiranës





"AFTËSI PËR TË GJITHË" PËR TË MËSUAR, PUNUAR, ANGAZHUAR

WORKSHOPE TEMATIKE

Përmbledhje dhe rekomandime

Workshop 1



Pjesëmarrësit në Workshop identifikuan disa nga çështjet dhe nevojat kyçe lidhur me punësimin dhe vet-punësimin si: (i) nevoja për përfshirjen e këshillimit të karrierës në arsimin e detyrueshëm; (ii) zhvillimi i skemave të internshipit për të rinjtë pjesë e programit NEET; (iii) përmirësimi i Ligjit për vullnetarizmin për të qenë më i dobishëm dhe mundësues në angazhimin e vullnetarëve; (iv) integrimi si pjesë e kurrikulave të modeleve të reja të mësimdhënies me fokus zhvillimin e aftësive praktike dhe të mësuarit, duke u vendosur “në këpucët e profesionistit”; (v) ndryshimi i mendësisë së mësimdhënies në shkolla (edukimi formal dhe jo-formal) në përshtatje me nevojat dhe ofertat e tregut të punës.

Rekomandimet kryesore: (i) Krijimi i një përvoje pune për punëkërkuarët e rinj si një mënyrë për të zhvilluar aftësitë dhe zhvillimin në karrierë; (ii) Njohja e programeve publike të punësimit dhe vetëpunësimit nga punëkërkuarët, duke përfshirë informacionin e ofruar nga zyrat rajonale të punës ose portalet online; (iii) Më shumë hapësirë dhe programe, jo vetëm si nisma të OSHC-ve për të mbështetur të rinjtë dhe të rriturit që dëshirojnë të fillojnë një biznes; (iv) më shumë përfshirje në skema dhe modele të aftësimin për aftësi digjitale, aftësi komunikimi dhe përshtatje me kërkesat e tregut; (v) Edukimi jo-formal duhet të integrohet në bashkëpunim të ngushtë me


edukimin formal, duke vendosur nxënësin në qendër të procesit të mësimit. Kjo qasje lejon të rinjtë të dalin nga zona e tyre e komfortit dhe të eksperimentojnë për të hyrë në tregun e punës me sukses. Për të përgatitur me efikasitet të rinjtë për punësim, është e rëndësishme të zbatohen metoda mësimi inovative që tejkalojnë qasjet tradicionale. Këto metoda duhet të inkurajojnë krijimtarinë, mendimin kritik dhe zhvillimin e aftësive praktike. Duke aplikuar edukimin jo-formal, individët e rinj mund të fitojnë një gamë të gjerë kompetencash që vlerësohen shumë në tregun e punës të sotëm, i cili po zhvillohet me shpejtësi. Është thelbësore që institucionet arsimore, krijuesit e politikave dhe palët e interesuara të bashkëpunojnë dhe të krijojnë një mjedis mbështetës që favorizon integrimin e edukimit jo-formal; (vi) Ka shumë iniciativa të ndërmarrura nga institucionet, organizatat dhe donatorët e ndryshëm, por mbeten të pakordinuara dhe shpesh herë operojnë në nivele lokale. Është e nevojshme të përmirësohet niveli i vizibilitetit për praktikën më të mira dhe të koordinohen në nivel kombëtar ato praktika që kanë funksionuar me sukses. Në këtë drejtim, është e rëndësishme të krijohet një platformë kombëtare që do të mundësonte ndarjen e njohurive, krijimin e partneriteteve të reja dhe zhvillimin e strategjive të përbashkëta për të përmirësuar aksesin dhe cilësinë e iniciativave për punësim në të gjithë vendin.

Punësimi dhe vetëpunësimi
Zhvillimi i aftësive për ekonomi më të qendrueshme dhe gjithëpërfshirëse

WORKSHOPE TEMATIKE

Përmbledhje dhe rekomandime

Workshop 2



Gjatë workshopit, organizatat e shoqërisë civile ndanë eksperiencat dhe theksuan rolin e rëndësishëm që luan sektori në:

- ofrimin e modeleve të punësimit të mbështetur të personave me aftësi të kufizuara;
- përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në programe të nxitjes së punësimit;
- nxitjen e hartimit të programeve specifike të punësimit për personat me aftësi të kufizuara;
- advokim dhe rekomandime konkrete në orientimin e kuadrit ligjor të punësimit, me qëllim përfshirjen në të të aftësisë së kufizuar;
- ndërgjegjësimin e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara për t'u qasur drejt punësimit;
- ndryshimin e sjelljes dhe qëndrimeve të komunitetit të biznesit për të punësuar dhe siguruar akomodimin e arsyeshëm në përputhje me nevojat.

Më tej si pjesë e diskutimeve, pjesëmarrësit u ndalën në disa prej sfidave kryesore lidhur me këtë tematikë si: (i) ndryshimi i paradigmës nga modeli mjekësor i trajtimit të PAK drejt atij të përfshirjes; (ii) mungesa e përgatitjes dhe orientimit të personave

me PAK drejt tregut të punës, kundrejt sigurisë financiare të ofruar nga skemat mbështetëse publike (pagesat e PAK); (iii) ambienti diskriminues; (iv) mungesa e përgatitjes nga shkollat dhe aftësimin e formimit profesional drejt punësimit; (v) shërbimet e OJF-ve për shkak të mundësive të kufizuara janë të pakta, të paqëndrueshme dhe nuk mbulojnë gjithë territorin; (vi) mungesa e bashkëpunimit institucional në menaxhimin e rasteve; (vii) fondi social i punësimit ende nuk është bërë aktiv.



Rekomandimet kryesore: (i) Zbatimi i fondit social të punësimit; (ii) Më shumë mbështetje nga shteti, donatorë dhe organizata ndërkombëtare me programe që kanë në fokus edukimin, aftësimin dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara; (iii) Rritja e mbështetjes, specifikisht me programe të aftësimin profesional dhe orientimit në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara, për punësim dhe vetëpunësim; (iv) Rritja e bashkëpunimit institucional dhe koordinimit mes institucioneve të shërbimeve sociale, atyre të punësimit dhe aftësimin dhe formimit profesional, për manaxhimin e integruar të rasteve.

Aftësimi dhe integrimi në punë dhe shoqëri i personave me nevoja të veçanta

WORKSHOPE TEMATIKE

Përmbledhje dhe rekomandime

Workshop 3





Si pjesë e diskutimeve nga pjesëmarrësit u theksuan: (i) rëndësia e angazhimit aktiv të të gjithë aktorëve në procesin e politikëbërjes, duke u dhënë atyre mjetet dhe njohuritë e nevojshme për një pjesëmarrje sa më efektive; (ii) mënyrat dhe modelet e ndryshme të fuqizimit të qytetarëve dhe grupeve të interesit, si dhe mbi strategjitë për të arritur angazhimin e tyre të qëndrueshëm në politikëbërje si përdorimi i teknologjisë për të nxitur pjesëmarrjen, organizimi i fushatave të informimit dhe zhvillimi i partneriteteve me sektorin privat dhe publik etj.; (iii) nevoja për një angazhim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për fuqizimin e aftësive të qytetarëve dhe grupeve të interesit nga të gjitha palët e përfshira në proces etj.

Rekomandimet kryesore: (i) të bërit bashkë të të gjithë aktorëve me qëllim vijimin në mënyrë të vazhdueshme të të mësuarit nga përvojat e njëri-tjetrit, sfidat dhe vështirësitë si dhe ardhja në ndihmë për kapërcimin e tyre; (ii) ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të ndërsjellta respekti dhe bashkëpunimi.

Demokracia pjesëmarrëse
Fuqizimi i aftësive të qytetarëve dhe grupeve të interesit për më shumë angazhim në politikëbërje

Workshop 4



Si pjesë e diskutimeve u theksua: (i) programet e aftësimit dhe integritit janë pjesë e procesit të manaxhimit të rasteve të personave të rritur në situatë vulnerabël, si një nga shërbimet më të rëndësishme për risocializimin e personave që mund të jenë viktimat e trafikimit, të dhunës në familje, apo në kushte të vështira të tjera socio-ekonomike; (ii) aftësimi dhe integrimi janë procese që kanë nevojë të pasurohen me teknika dhe shumëllojshmëri modesh të miratuara dhe që do të duhen të aplikohen kryesisht në nivel lokal nga shërbim-ofruesit pranë qendrave komunitare, NARU, etj; (iii) programet kryesisht ofrohen nga projektet e organizatave të shoqërisë civile (për rastet e dhunës në familje, viktimave të trafikimit, grupeve etnike si romët dhe egjiptianët etj.); (iv) këto programe janë të bazuara në projekte afatshkurtra, shpeshherë të paqëndrueshme për shkak të Kostos që kanë.



Rekomandimet kryesore: (i) është me rëndësi subvencionimi apo nënkontraktimi i programeve mbi aftësimin dhe rintegritit të grupeve vulnerabël të organizatave të shoqërisë civile, të ngritura mbi praktika të testuara në kohë dhe grupet e përfituesve; (ii) këto programe kanë nevojë të jenë të vazhdueshme dhe të diversifikuara në përputhje me vështirësië e grupeve vulnerabël pasi asnjë rast nuk i ngjan tjetrit; (iii) planifikimi dhe buxhetimi i këtyre programeve në nivel lokal në përputhje me nevojat e grupeve vulnerabël duke siguruar aksesueshmëri dhe besueshmëri tek përfituesit.

Aftësimi dhe integrimi i personave
nga grupe të disavantazuara

WORKSHOPE TEMATIKE

Përmbledhje dhe rekomandime

Workshop 5



Çështjet dhe nevojat kyçe të identifikuara: mjedis ligjor jomundësues për promovimin dhe zhvillimin e aftësive për jetën si ndryshimet në Ligjin “Për Rininë” që ka rezultuar në mbylljen e qendrave rinore ekzistuese për shkak të kufizimeve në fonde vendore apo Ligji “Për Vullnetarizmin” si aspak mundësues për organizatat dhe vullnetarët; ndryshimet në staf të administratës shtetërore në institucione përgjegjëse për zhvillimin dhe promovimin e aftësive të buta, përbën një pengesë dhe sfidë të vazhdueshme; mungesa e aksesit ose akses i kufizuar i OSHC-ve në institucionet arsimore dhe bashkëpunimin me Zyrat Vendore Arsimore, për zbatimin e nismave të aftësimin për jetën për fëmijët dhe të rinjtë (si pasojë e centralizimit të autorizimit për akses); nevojat e organizatave lokale për zhvillimin kapacitetesh në ofrimin e shërbimeve për aftësitë për jetën, me fokus të veçantë fëmijët në moshën e adoleshencës; mungesa e shërbimit të informimit dhe këshillimit online (parashikuar edhe në Strategjinë Kombëtare të Rinisë dhe Planin e Veprimit 2022-2029) për të krijuar akses në shërbime për të rinjtë në nivel lokal në mbarë vendin etj.

Rekomandimet kryesore: (i) advokimi në institucionet përgjegjëse për integrimin dhe përfshirjen e programeve arsimore për zhvillimin e aftësive të buta (soft skills) në arsimin fillor, si faktor kyç për zhvillimin e

fëmijës; (ii) njohja e rëndësisë dhe kontributit të punës së OSHC-ve si ofrues të shërbimeve të munguara nga shteti, lidhur me zhvillimin e aftësive të buta, bashkëpunim me mbështetje e OSHC-ve në këtë drejtim për vijimin e shërbimeve; (iii) forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit OSHC- institucione shtetërore, veçanërisht në nivel lokal, me qëllim përmirësimin e mjedisit mundësues për zhvillimin e aftësive për jetën; (iv) zbatimi i programeve sa më gjithëpërfshirëse dhe të targetuara sipas nevojave të përfituesve qofshin këta të rinj, fëmijë, njerëz në vështirësi ekonomike dhe nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, të rinjtë me aftësi ndryshe, vajzat dhe gratë në nevojë dhe ato në zona rurale, të moshuarit etj. (v) ndryshimi i qasjes dhe metodologjisë së mësimdhënies duke synuar të mësuarit nëpërmjet praktikës si dhe mjeteve bashkëkohore digjitale, si një mënyrë më atraktive dhe efektive në përvetësimin e aftësive për jetën; (vi) më shumë nisma dhe programe me fokus aftësimin dhe orientimin drejt tregut të punës të të rinjve në zonat rurale, si një grup potencial në risk për emigrim; (vii) ndërgjegjësimi i stafit pedagogjik të arsimit të detyrueshëm mbi rëndësinë e aktivizimit në komunitet dhe vullnetarizmit tek fëmijët dhe të rinjtë, si dhe nxitjes dhe promovimit të tyre.

Aftësitë për jetën



Ky projekt financohet nga Bashkimi European

Shqipëri
Java e Shoqërisë Civile
2023

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI



ORGANIZATAT DHE INSTITUCIONET PARTNERE TË #JSHC2023



Na kontaktoni

 www.resourcecentre.al

 info@resourcecentre.al

